



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCEVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE
DREJTORIA E SHËRBIMIT PËR TATIMPAGUESIT
Sektori i Edukimit dhe Marrëdhënieve me Publikun

Nr. 36940/6 Prot.

Tiranë, më 14.12.2016

Lënda: Kthim përgjigje

Drejtuar: Z. Marios GIATZIDIS
Drejtor i Departamentit Ligjor dhe Rregullator
Vodafone Albania SHA
Autostrada Tiranë-Durrës, Rruga "Pavarësia", nr.61, Kashar

TIRANË

I nderuar z.Giatzidis,

Në cilësinë e kërkuarit, keni depozituar në formë shkresore, kërkesën për informacion nr.LRD/0126/ESH datë 09.11.2016, protokolluar në DPT nr.36940 Prot, datë 10.11.2016 si dhe regjistruar në regjistrin e kërkesave me numër rendor 10 datë 24.10.2016, bazuar në Ligjin nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", në të cilën kërkonti një kopje të shkresës nr.11700 Prot, datë 28.12.2010, drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve nga Ministri i Financave.

Pas shqyrtimit të kërkesës, e cila ishte në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", ju bëjmë me dije se arkiva e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nuk e disponon dokumentin e kërkuar nga ju.

Ju falenderojmë për mirëkuptimin,

ZV/DREJTOR I PËRGJITHSHËM

XHAVIT ÇURRI